

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ZHEGROVA”**

**Kapitulli I**

**EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

Në cilësinë e ortakëve:

- 1- **Kumrije Zhegrova**, lindur më 29.01.1976, lindur në Vushtri, Kosovë, e bija e Abdulla, mbajtëse e pasaportës me numër P01222405 dhe me numër personal 1005102347
- 2- **Thierry Joseph Germain Delalande**, lindur më 02.12.1964, lindur në Domfront, Francë, i biri i Jean,mbajtës i pasaportës me numër 20C135573  
të cilët me cilësinë e ortakëve themelues kanë redaktuar këtë statut ku me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e të singertë dhe me inisiativën e tyre private mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Kodin Civil në fuqi, në Ligjin nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” krijojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“ZHEGROVA”**.SHPK

**Neni 1 – Forma**

- 1.1. Shoqëria **“ZHEGROVA” shpk** harton këtë statut në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe të Ligjit nr. 131/2015, “Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.2. Shoqëria **“ZHEGROVA” shpk** është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) dhe aktiviteti i saj rregullohet me anë të këtij statuti.
- 1.3. Shoqëria vepron në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 1.4. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare

**Neni 2 – Emri**

- 2.1 Emri i shoqërisë është **“ZHEGROVA”SHPK**

**Neni 3 – Objekti**

- 3.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të materialeve te ndertimit, si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike që do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimeve te shoqerise e që nuk bie ndesh me legjislacionin ne fuqi.

- 3.2. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti.
- 3.3. Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qellimeve të saj.



#### **Neni 4 – Selia**

- 4.1. Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në: **Rruja Çameria, Pallati Boga, shk.1, ap 1, Zona Kadastrale 8632, Pasuria Nr. 2/184 Lezhe.**
- 4.2. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë kudo, brënda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 5 – Kohëzgjatja**

- 5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa kufizim.
- 5.2. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati me vendim të asamblesë së përgjithshme.

#### **Neni 6 – Përgjegjësitë**

- 6.1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti.
- 6.2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emrin e tyre personal ndaj personave të tretë.

### **Kapitulli II**

#### **KAPITALI I SHOQERISE**

#### **Neni 7 – Kapitali**

7.1 Kapitali i nënshkruar i shoqërisë, është **6.000,000** (Gjashtë milion) lekë i ndarë në 2 kuota.

#### **Neni 8 – Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre**

8.1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë zotërohen nga ortakët si më poshtë:

**Zj. Kumrije Zhegrova**, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 3.060,000 lekë ose 51% të kapitalit

**Z. Thierry Josef Germain Delalande**, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 2.940,000 lekë ose 49% të kapitalit

#### **Neni 9 – Zmadhimi i kapitalit**

- 9.1. Asambleja e përgjithshme mund të rrisë pa kufi kapitalin e shoqërisë.
- 9.2. Rritja e kapitalit mund të bëhet nëpërmjet financimoit të ortakëve ose nëpërmjet përfshirjes në kapital të fitimeve dhe rezervave të shoqërisë.
- 9.3. Administratorët njoftojnë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.
- 9.4. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

- 9.5. Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme vendos edhe për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë që me këto fitime të zmadhojë kapitalin e regjistruar, të rrisi rezervat statutore ose të shpërndajë divident.
- 9.6. Në asnjë rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë pa mbuluar më parë humbjet e rezultuara në pasqyrat financiare.
- 9.7. Në përputhje me nenin 77 të ligjit 9901 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtarë", përpara se të vendoset për shpërndarje dividenti, administratorët lëshojnë çertifikatë të aftësisë paguese. Kjo çertifikatë lëshohet vetëm në se pas pagimit të dividentit, aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brënda 12 muajve në vazhdim.

#### **Neni 10 – Krijimi i rezervave**

- 10.1 Mbas miratimit të pasqyrave financiare, asamblea krijon rezerva statutore. Rezerva statutore duhet të jetë për çdo vit jo më pak se 10% e fitimit vjetor. Kur këto rezerva të kapin shumën sa 10% të kapitalit themeltar, asamblea e ortakëve mund të mos krijojë më rezerva.

#### **Neni 11 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 11.1. Asambleja e përgjithshme mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 11.2. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njostohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim, nga administratorët. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

#### **Neni 12 – Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes**

- 12.1. Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.
- 12.2. Transferimi për çfarëdo arsyje, tërësisht ose pjesërisht i kuotave të kapitalit të shoqërisë është subjekt i të drejtës së parablerjes, në favor të ortakëve të tjerë, të cilët mund të ushtrojnë këtë të drejtë, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomande, i cili përmban ofertën. Në rast se ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se kanë hequr dorë prej të drejtës së parablerjes.
- 12.3. Në rast se njëri prej ortakëve refuzon apo heq dorë nga ushtrimi i të drejtës së tij të parablerjes, ortakët e tjerë, të cilët tashmë kanë ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes, mund ta ripërdorin këtë të drejtë edhe për pjesën e ofruar ortakut që e refuzoi atë.
- 12.4. Në rast se më shumë se një ortak dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e parablerjes, kuotat e kapitalit të ofruara ortakut që nuk dëshironë ta ushtronë të drejtën e tij, ndahen në proporcion me pjesët e kapitalit respektiv.
- 12.5. Në rast se vetëm njëri prej ortakëve dëshiron ta ushtrojë të drejtën e parablerjes, kuotat e kapitalit të ofruar i transferohet atij tërësisht ose në atë masë që ky ortak dëshiron.

- 12.6. Ortakët që dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e tyre të parablerjes duhet t'i njoftojnë vendimin e tyre ortakut që dëshiron të transferojet kuotat e tij të kapitalit brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, që prej marrjes së lajmit për mos ushtrimin e së drejtës së parablerjes prej ndonjërit prej ortakëve.
- 12.7. Të gjitha njoftimet e sipërpermendura do të bëhen me shkrim dhe i adresohen administratorit të Shoqërisë.

### Neni 13 - Pasojat e kalimit të kuotave

13.1 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

## Kapitulli III

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRIMI, KONTROLI

#### Neni 14 – Të drejtat dhe detyrimet

- 14.1 Organi më i lartë drejtues i Shoqërisë “**ZHEGROVA**” shpk është asamblea e ortakëve. Të gjitha vendimet e marra nga asamblea e ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar;
  - d) përcaktimin e shpérblimeve për personat e përmendor në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

#### Neni 15 - Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

- 15.1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji, dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.



- 15.2. Asamblea e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.
- 15.3. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjeter aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton na pasqyrat financiare të çertifikuara nga eksperti kontabël.
- 15.4. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët.

#### **Neni 16 - Mënyra e thirrjes së asamblesë**

- 16.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi me shkresë duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpresa datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 16.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 17 - Kërkesa nga ortakët e pakicës**

- 17.1 Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të Shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës.

#### **Neni 18 - Përfaqësimi në asamble**

- 18.1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë.
- 18.2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 18.3. Autorizimi mund të jebet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 19 - Kuorumi**

- 19.1 Në rastin e marjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht.

- 19.2 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

#### Neni 20 - Marrja e vendimeve

- 20.1. Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 20.2. Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështjet e tjera.
- 20.3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

#### Neni 21 - E drejta e votës

- 21.1. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 21.2. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

#### Neni 22 - Përjashtimi nga e drejta e votës

- 22.1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 22.2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### Neni 23 - Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

- 23.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
- 23.2. Prosesverbali përban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 23.3. Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 23.4. Prosesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

#### Neni 24 - Hetimet e posaçme



Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të Shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, ne perputhje me rregullat e percaktuara ne nenin 91 te Ligjt Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

### Neni 25 - Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjt ose të statutit, ne perputhje me rregullat e percaktuara ne nenin 92 te Ligjt Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtarët dhe shoqeritë tregtare".

### Neni 26 – Administrimi

- 26.1. Shoqëria administrohet nga administratorët. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje. Duke filluar nga data e miratimit të këtij statuti, administratori i shoqërisë "ZHEGROVA" shpk për një periudhë 5-vjeçare do të jetë Znj. Kumrie Zhegrova, madhore, lindur Vushtri, Kosovë.
- 26.2. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 26.3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë, me shumicë të zakonshme.

### Neni 27 - Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

- 27.1. Administratorët detyrohen të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërsi. Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Blerim Lulaj".

## **Kapitulli IV**

### **SHPËRNDARJA E FITIMIT**

#### **Neni 28 - Shpërndarja e fitimeve**

28.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të dekluaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara .

28.2 Aktiviteti i shoqerise mbylljet ne 31 Dhjetor te çdo viti. Bilanci duhet te shoqerohet nga një relacion i asamblese se ortakeve qe sqaron mbarevajtjen e administrimit ne sektore te ndryshem te aktivitetit te shoqerise duke i kushtuar një vemendje te madhe investimeve, çmimeve dhe kosteve si dhe fakte te tjera te rendesishme te verejtura pas mbylljes se aktivitetit te periudhes.

28.3 Bilanci dhe relacioni i asamblese se ortakeve duhet te depozitohet prane selise se shoqerise 15 dite para mbledhjes se ortakeve qe do te thirren per ta aprovuar. Shperndarja fitimit te ushtrimit konsistone: 5% te fitimin e kalon ne rezerva ligjore deri ne 1/10 kapitalit, 10% te fitimit ne rezerva statutore, diferenca mund ta shpendaj ne forme dividenti apo te beje shtese kapitali.

28.4 Pasqyrat Financiare ne fund te periudhes ushtrimore do te Auditohen nga Auditues Ligjor te emeruar me vendim te asamblese se ortakeve.

## **Kapitulli V**

### **PRISHJA E SHOQËRISË**

#### **Neni 29 - Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

29.1 Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk kryen veprimtari tregtarë për dy vjet ;
- d) me vendim të gjykatës;

#### **Neni 30 - Largimi i ortakut për shkaqe të arsyeshme**

30.1 Ortaku mund të largohet apo perjashtohet nga shoqëria në kushtet dhe sipas procedurave te percaktuara ne Ligjin Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtarët dhe shoqeritë tregtare".

#### **Neni 31 – Amendamentet**

31.1 Ketij statuti mund t'i behen amendamente sa here qe asambleja e sheh te arsyeshme. Per amendamentet asambleja duhet te vendose sipas percaktimeve qe ben ligji.



Ky Statut hartohet në 2 kopje në gjuhen shqipe.

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

Kumrije Zhegrovë

*Kumrije Zhegrovë*  
Kumrije Zhegrovë

Lezhë, më 27.02.2023

Thierry Joseph Germain Delalande

*Thierry Joseph Germain Delalande*  
~~Thierry Delalande~~  
~~Delalande~~

*Jamë "nyohës" i gjithës shqiptarë*  
~~Delalande~~  
~~Delalande~~